

## FJALA E DEPUTETES MIRELA KUMBARO

E ENJTE 13 TETOR 2022

Në fakt, kjo foltore nuk është dhe nuk duhet të jetë as shtëpi njoftimesh funerale, aq më pak mikrofon mallkimesh të të gjitha llojeve. Për të folur për sezonin turistik, zonja Kryetare, mbase do të duhej shumë më tepër kohë sesa 20 minutat që parashikon Rregullorja, ndaj kam zgjedhur si model Sarandën e këtij sezoni veror, sepse mund të jetë me interes të drejtpërdrejtë, si një ndër simbolet e turizmit shqiptar. Media e njohur zvicerane “20 Minuten”, në datën 28 gusht sugjeroi 5 destinacione plazhi të preferuara për turistët, jo vetëm zviceranë, por edhe për të tjerë, për muajin shtator.

E para në këtë listë ishte Saranda, ndjekur nga ishulli Hyeres në Francë, plazhet e fshehura në pyjet e Stambollit, plazhet shkëmbore të Algarves në Portugali dhe plazhet e Kalabrisë në Itali. Një tjetër revistë turistike e rëndësishme franceze “Generacion Voyage”, shkruan për Sarandën, vetëm një javë më parë, këtë cilësim: “Shija e Karaibeve në Sarandë”. Saranda është rasti tipik, por jo i vetmi në këtë vjeshtë të parë, ku sezoni turistik nuk mbyllet me gushtin, por vijon edhe në shtator, me hotele të rezervuara me kapacitet të plotë deri më 15 shtator nga grupe turistike dhe me 70 deri në 80% më 30 shtator. Origjina e turistëve për muajin shtator, i cili nuk është piku i sezonit, është e larmishme: gjermanë, italianë, polakë dhe shumë grupe të planifikuara nga vendet nordike. Operatorët turistikë vendorë e cilësojnë këtë shtator si më të mirin për numrin e turistëve dhe zënien e kapaciteteve akomoduese.

Edhe muaji tetor konfirmohet më i mirë sesa tetori i një viti më parë, pasi rezervimet vijnë. I rëndësishëm për këtë vit ishte rikthimi i kroçerave, të cilat për një periudhë 3-vjeçare munguan, edhe për shkak të pandemisë. Ju njoftoj se kroçera e parë për këtë vit mbërriti në Sarandë më 8 prill, kroçera e radhës ndaloi në Sarandë më 11 tetor dhe tjetra do të jetë më 25 tetor. Turistët që hynë përmes portit të Sarandës, duke përfshirë edhe linjat ditore nga Korfuzi, shënuan një rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2022. Vetëm për periudhën janar-gusht në Portin turistik të Sarandës u trajtuan mbi 250 mijë pasagjerë. Për të kuptuar tendencën e shtatorit, vetëm në

këtë muaj kanë hyrë në Portin e Sarandës 32 mijë e 136 vizitorë krahasuar me 7636 vizitorë gjatë muajin shtator të vitit 2021.

Prenotimet në hotelet e Sarandës dhe të Ksamilit janë shumë domethënëse. Nëse për periudhën maj-qershor okupimi i strukturave akomoduese arriti mbi 60% të kapacitetit të tyre, në periudhën korrik-gusht këto njësi ishin të zëna në masën 100%. Vlen të theksohet se në Sarandë, që ta kuptojmë pak a shumë, dhe në Ksamil, ka rreth 900 njësi akomoduese, hotele, break and breakfast dhe shtëpi të dyta, që përkthehen në mbi 25 mijë shtretër. Duke iu referuar shifrave, mund të themi se krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kemi një rritje me mbi 25% të prurjes turistike. Po flas vetëm për Sarandën.

Sivjet vlerësohet kthimi i turistëve nga Europa Qendrore dhe Perëndimore, si dhe shtimi i turistëve gjermanë, spanjollë, francezë, italianë dhe anglezë. Pas një pauze 3-vjeçare kemi një rikthim të dukshëm të turistëve nordikë, ku përfshihen kryesisht ata norvegjezë, danezë, suedezë, finlandezë, por edhe turistët nga Europa Qendrore. Risi ishte ardhja në numër të konsiderueshëm e turistëve spanjollë, që në rang vendi kaloi mbi 4,5 herë më shumë sesa vitin e kaluar, apo e turistëve italianë, që erdhën 85% më shumë se vitin e kaluar. Për Sarandën mbetet interesante edhe shitblerja e pasurive të patundshme nga blerës të huaj, sidomos nordikë, francezë dhe italianë, që tashmë janë taksapagues të rregullt të pushtetit vendor në periudhën që flasim.

Sukses i padiskutueshëm i kësaj vere ishte edhe hapja e re e rrugës dhe tunelit Kardhiq-Delvinë. Në fakt, kjo rrugë ishte një vlerë e shtuar jo vetëm për Sarandën, por edhe për Gjirokastrën, e cila përfitoi sivjet nga një fluks i ri turistësh, të cilët destinacionin e parë kishin Sarandën, por e kishin shumë më të lehtë të kalonin ditë, kohë vizite turistike dhe të shpenzonin para në Gjirokastrë, por edhe për fshatrat e Kardhiqit, që tashmë shikojnë një mundësi të re, një treg të ri për të shitur produktet e tyre lokale, gjë që filloi këtë behar. Këto flukse kanë ndikuar edhe në shitjen e pasurive të patundshme me qëllime turistike në Gjirokastrë, duke synuar jo vetëm turizmin në qarkun e Gjirokastrës, por edhe bregdetin e Sarandës. Në këtë kontekst të ri është për t'u vlerësuar bashkëpunimi i 4 bashkive të zonës: Sarandë, Finiq, Himarë dhe Konispol në marrëveshjen e tyre të përbashkët për turizëm të integruar.

Çdo turist që vjen në Sarandë informohet se jo shumë larg detit, të cilin e kishin destinacionin kryesor, dhe Ksamilit, janë edhe malet e fshatrave të Finiqit dhe Parku Arkeologjik i Finiqit; është xhamia e Gjin Aleksit në Rusan të Delvinës; është monumenti i natyrës së Syrit të Kaltër, tashmë i zgjeruar në një park natyror me një investim të ri të rikualifikimit të Parkut me rrugët e aksesit, shtigjet për shëtitje, pikat panoramike dhe parkim të dedikuar; është kisha e Shën Gjergjit ose Manastiri i Mesopotamit; janë krojet e Xhemarhallës në Delvinë apo platanacionet e mandarinave në Murësi dhe Konispol.

Një tjetër risi e kësaj vere në punët e mira të Bashkisë së Sarandës është lehtësim i infrastrukturës përmes bajpasit Lëkurës-Kanali i Çukës, nëpërmjet të cilit u lehtësua kalimi i të gjithë pushuesve që kishin destinacion Ksamilin, pa qenë e nevojshme që ata të hynin në Sarandë, dhe po kështu edhe për dalje. Ky investim bëri që në Ksamil të udhëtohej duke kursyer kohë, duke përshkruar një rrugë panoramike pa sjellë rëndim të trafikut dhe duke rritur dukshëm vlerën e investimeve të pasurive të patundshme të pronës në atë zonë. Këtë verë u rikonstruktuan të gjitha pikat e informacionit turistik në Sarandë, të cilat kanë qenë të hapura nga ora 8:00 e mëngjesit deri në mesnatë, me fletëpalosje dhe harta turistike, pa harruar të gjitha informacionet e shpërndara në kohë reale në të gjitha rrjetet sociale, fatmirësisht të shpërndara dhe të shumëfishuara nga shumë medie të huaja.

Kjo verë, nga 1 qershori deri më 15 shtator, ka pasur rregullisht të paktën 1 shkrim në javë në mediet më prestigjioze, duke i bërë promovim turizmit dhe destinacioneve turistike shqiptare, që nga "Financial Times", "The Guardian's", "Le Monde", CNN e kështu me radhë. Kjo verë në Sarandë, si një model i vogël Shqipërie, ka pasur mbi 100 aktivitete, festivale, panaire, koncerte për të rritur dhe fëmijë, që shoqëruan të gjithë sezonin turistik veror, për të cilat nuk është nevoja të zgjatëm, sepse mjafton të shikojmë në rrjete sociale dhe mund t'i gjejmë të gjitha informacionet. Ndërkohë, një aspekt shumë i rëndësishëm kësaj vere ka qenë përpjekja e madhe e bashkisë dhe e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për të mbajtur pastër një territor që për 3 muaj u popullua 10 herë më shumë se numri i zakonshëm i banorëve që jetojnë aty 9 muajt e tjerë.

Pa asnjë dyshim Saranda këtë vit ka qenë më e pastër, siç ka qenë më e pastër Himara, Durrësi, Kavaja, Lezha dhe Pogradeci për të qëndruar në territoret e vijave bregdetare, në të cilat ka një mbipopullim të dukshëm në sezonin e verës. Për 3 muaj rresht vetëm në bregdetin e Sarandës janë pastruar çdo ditë dhe çdo natë 18,2 kilometër linearë ose 9 milionë e 536 mijë metër katrorë. Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka mbikëqyrur sezonin përmes monitorimit të përditshëm të plazheve. Po qëndroj sërish te Saranda, që, në fakt, ka vijën bregdetare më të shkurtër krahasuar me bregdetin e Himarës, Vlorës, Kavajës, Durrësit, Velipojës, Lezhës e të tjera. Vetëm në Sarandë janë kryer 80 inspektime në stacionet e plazhit, ku janë marrë 27 masa administrative, janë kryer 41 kontrole në strukturat akomoduese në Sarandë dhe 27 tour-operators midis Sarandës dhe Gjirokastrës.

Në qytetin e Sarandës, në buzë të shëtitores, plazhet publike kanë qenë model që nga pastërtia, sinjalistika, shërbimi i vrojtuesve të plazhit, të gjitha të administruara nga bashkia. Gjithashtu, falë administrimit të kujdesshëm të sezonit, Bashkia e Sarandës ka arkëtuar, vetëm nga stacionet e menaxhuara, mbi 64 milionë lekë të rinj ose 64% më shumë se viti 2019, që i janë rikthyer publikut në shërbim pastërtie, mirëmbajtjeje, kontrolli territori, duke përfshirë këtu edhe stacionin e ndarjes së mbetjeve në burim, stacionin e riciklimit, për të cilin Saranda po tregon se si mund të funksionojë ekonomia qarkulluese. Meqenëse po flasim për plazhet, dua të ndaj me ju faktin që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka filluar tashmë punën për vitin 2023.

Nëse për vitin 2022 e filluam më herët se çdo vit, në janar, tashmë e filluam punën në fund të gushtit dhe jemi gati me hartëzimin e stacioneve të plazhit; është miratuar VKM-ja përkatëse dhe në datën 1 nëntor, përfitoj nga kjo foltore për ta shpërndarë si informacion, por ju kërkoj edhe deputetëve të bashkive bregdetare të na ndihmojnë në shpërndarjen e informacionit për një organizim më të mirë të punës, se nga 1 nëntori deri më 30 nëntor do të jetë faza e aplikimit të subjekteve, që punojnë dhe prodhojnë ekonomi në këtë sektor. Ndërkohë, me VKM-në e re kemi rritur minimumin e detyrueshëm për plazhet publike. Megjithëse minimumi praktikisht ka qenë 20% në rregulloren e vjetër, realiteti ka qenë se në plazhet midis parcelave publike dhe parcelave të menaxhuara nga subjekte private, ndarja ka qenë pothuajse 50% me 50% në të gjithë vijën e bregdetit shqiptar.

Megjithatë, këtë minimum e kemi rritur dhe do të jemi gjithmonë në monitorim, që jo vetëm thjesht të kemi administrim të parcelave, por të kemi edhe garantimin e kushteve, siç janë vrojtuesit. Sivjet kemi edhe një vlerë të shtuar, pasi ka hyrë tashmë në fuqi një tjetër vendim i Këshillit të Ministrave për bregëzimin dhe ankorimin e mjeteve lundruese turistike në zbatim të ligjit “Për turizmin” të vitit 2020, i cili është gati për zbatim; është ngritur komisioni, është ndarë numri maksimal i vendparkimeve për mjetet turistike lundruese për çdo bashki bregdetare dhe jemi gati për të pritur aplikimet e para të operatorëve ekonomikë që kanë aktivitetin e turizmit detar.

Po kështu, përfitoj nga ky rast të sjell në vëmendjen e publikut dhe të të interesuarve, që operatorët turistikë detarë duhet të jenë të certifikuar sipas sistemit të hyrë në fuqi tashmë në Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit me një udhëzim të të dedikuar dhe të detajuar të ministrit, për të cilin njoftoj se nuk do të ketë operatorë të turizmit detar, të cilët nëse nuk e kanë këtë certifikatë, të mund të ushtrojnë aktivitetin e tyre. Këto masa ndihmojnë jo vetëm për të administruar sezonin e plazhit, por për të administruar sa më mirë bregdetin si një aktivitet turistik të organizuar si një ekonomi më vete në vitet e fundit.

Jemi mësuar përgjithësisht në kujtesën tonë të flasim për pushime në plazh, por një ekonomi e mirëfilltë me rregulla, kjo është një degë e re e ekonomisë e zhvilluar vitet e fundit, por të mos harrojmë se deti ka qenë përgjithësisht armiqësor historikisht, kemi pasur një moratorium që ka vazhduar deri në vitet 2014. Pra, të gjitha këto rregulla, që zhvillohen bashkë me zhvillimin e sektorit, janë tashmë në fuqi për të garantuar për vitin 2023 një vit më të organizuar dhe më të sigurt për të gjithë pushuesit. Gjithashtu, dua të theksoj se është e rëndësishme të themi se punët e mira fillojnë në mëngjes, siç e thotë populli.

Ky është mëngjesi i sezonit të ardhshëm veror, për të qëndruar vetëm te sezoni veror, sepse të flasësh për turizmin do të na duheshin shumë më tepër seanca dhe ia vlen të flitet, sepse turizmi sivjet ka qenë jo vetëm më i mirë se çdo vit, jo vetëm i shpërndarë në të gjithë territorin, po të kemi parasysh të dhënat e fundit të INSTAT-it, që preferencat e turistëve të huaj në masën 41% kanë qenë për Veriun e Shqipërisë, për turizmin malor, për agroturizmin,

çka flet për një shtrirje të hartës turistike përtej bregdetit me të cilin ishim mësuar ta shikonim turizmin, dhe jo vetëm kaq, por flitet edhe për një shtrirje në kohë.

Nëse sot frekuencat e para të grupeve turistike fillojnë në muajin mars, që përkon edhe me fillimin e kohës së ngrohtë, dhe vazhdojnë deri në muajin nëntor, përtej datës zyrtare të sezonit turistik, që është 15 nëntori, kjo tregon për zhvillimin e atraksioneve të reja turistike, që nga zonat e mbrojtura, agroturizmi, turizmi i aventurës dhe ai bregdetar. Sado që mund të duket si mungesë modestie, këta tregues e renditin Shqipërinë, ashtu sikurse e ka thënë edhe Organizata Botërore e Turizmit para një jave, të parin vend në Europë për rikuperimin e numrit të turistëve pas periudhës së pandemisë, me 19% më shumë vizitorë krahasuar me vitin 2019 dhe të dytin në botë. E thotë Organizata Botërore e Turizmit, jo unë. Faleminderit!